



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

Nr _____ Prot

Gjirokastër më _____.____.2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

[20.01.2026]

Drejtuar: OE RO-AL SHPK me NIPT J61811001M me adrese: Tirane Kashar KASHAR KM.8
AUTOSTRADA TIRANEDURRES

Tipi i Kontratës: mall

Lloji i Procedurës së prokurimit: **E hapur e thjeshtuar**

Numri i Procedurës /referenca e Lotit: **REF-70507-11-27-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Materiale për mobilim ambientesh”**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 02.12.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike [09.12.2025] [78]

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐ x

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **OE "RO -AL" SHPK** me NIPT J61811001M me vlerë te ofertes së ofruar **967,200 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind)** lekë pa tvsh.
2. **OE AK GREEN KONSTRUKSION SHPK** me NIPT M11321005I me vlerë te ofertes së ofruar **999,500 (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë** pa tvsh.

3. **OE Albanian Furniture Office Sh.p.k** me NIPT M32303056L me vlerë te ofertes së ofruar **890,000 (tetëqind e nëntëdhjetë mijë)** lekë pa tvsh.
4. **OE SHAGA. SHPK** shpk me NIPT J96822229J me vlerë te ofertes së ofruar **659,200 (gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e dyqind)** lekë pa tvsh.
5. **OE T&J Construction SH.P.K** me NIPT M29718101T me vlerë te ofertes së ofruar **990 000 (nëntëqind e nëntëdhjet mijë)** lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1.Më pas KVO-ja në mbështetje të nenit 93 te LPP-së Nr 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 82, verifikoi ofertat e mbetura në garë (të vlefshme) sipas formulës për oferta anomalisht të ulëta të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit, nga ku rezultoi se **OE SHAGA. SHPK** shpk me NIPT J96822229J me vlerë te ofertes së ofruar **659,200 (gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e dyqind)** lekë pa tvsh është në kushtet e *ofertës anomalisht të ulët*. Për këtë arsye **OE SHAGA. SHPK s’kualifikohet**.

2.Në vijim të **Proces-verbalit të vlerësimit të ofertave**, të mbajtur më datë **23.12.2025**, për procedurën e prokurimit me objekt “**Materiale për mobilim ambientesh**”, ku Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në bazë të kriterit të vlerësimit “**çmimi më i ulët i ofertave të kualifikuara**”, ka bërë klasifikimin përfundimtar të operatorëve ekonomikë dhe ka renditur në vend të parë **OE Albanian Furniture Office Sh.p.k**, me NIPT **M32303056L**, me vlerë oferte **890,000 (tetëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH**, Autoriteti Kontraktor ka vijuar me fazën pasuese të procedurës.

- ❖ Në zbatim të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik dhe Dokumenteve Standarde të Tenderit, operatorit ekonomik të renditur në vend të parë i është dërguar **kërkesa zyrtare për dorëzimin e dokumentacionit fizik**: Dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a” “b” “d” “dh” “e” “h” “i” “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM 285/2021 “Për prokurimin publik” si dhe dokumentet shoqeruese të ofertës të tenderit të dorëzuara në rrugë elektronike,brenda afatit të përcaktuar **5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes publikimit të këtij njoftimi** me shkresë përkatëse të protokolluar me nr. 13246, datë 23.12.2025.

Brenda këtij afati, **OE Albanian Furniture Office Sh.p.k** ka paraqitur dokumentacionin fizik, i cili është marrë në shqyrtim nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresë nr. 13318, datë 29.12.2025.

- ❖ Nga kontrolli i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se **dokumentacioni nuk ishte i plotë**, pasi mungonin disa dokumente të kërkuara sipas Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe kushteve të kualifikimit si më poshtë:
 1. Bilancet 2023,2024.
 2. Ekstraktin e thjeshte dhe historik nga Qendrën Kombëtare të Biznesit.
 3. Vërtetim të statusit aktiv.

4. Vertetim nga Gjykata për subjektin dhe administratorin.
5. Vertetim nga Prokuroria subjektin dhe administratorin.
6. Vertetim nga Drejtoria e Burgjeve për OE.
7. Vërtetim të taksave vendore 2025..
8. Vërtetim detyrimesh tatimore.
9. Vertetim nga OSHEE për muajin nëntor 2025.
10. Vërtetim të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore.
11. Vërtetim nga Agjencia e Prokurimit Publik për mospërfundim nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik.
12. Vërtetim pronar përfitues në regjistrin e pronave përfituese.

- ❖ Për këtë arsye, në mbështetje të nenit 82 të VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor i ka dërguar operatorit ekonomik **kërkesë për plotësimin e dokumentacionit që mungonin si të sipërcituara**, me shkresë nr.4 prot, datë 05.01.2026, duke i lënë afatin ligjor për paraqitjen e dokumentave. Brenda afatit të përcaktuar në këtë kërkesë, **operatori ekonomik nuk paraqiti dokumentacionin e kërkuar**, duke mos përmbushur detyrimet e parashikuara në Dokumentet Standarde të Tenderit dhe legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se **OE Albanian Furniture Office Sh.p.k nuk përmbush kushtet për shpalljen përfundimtare fitues**, për shkak të mosdorëzimit të plotë të dokumentacionit fizik brenda afatit të përcaktuar.
- ❖ Për rrjedhojë, KVO-ja, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285/2021, vendosi **s’kualifikimin e OE Albanian Furniture Office Sh.p.k** dhe vijimin e procedurës me **operatorin ekonomik të renditur në vend të dytë**, sipas klasifikimit të miratuar në procesverbalin e vlerësimit të ofertave.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE RO-AL SHPK** me NIPT J61811001M me adresë: Tirane Kashar KASHAR KM.8 AUTOSTRADA TIRANEDURRES se oferta e paraqitur me vlerë totale **967,200 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind)** lekë pa tvsh është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

ZYRTARI I AUTORIZUAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nertil Nebiaj